



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.726/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelet e Munib Durguti, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes, mungesë e votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021. në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHËN të pa palejuara Apelet Anr.726/2021, Anr.727/2021, Anr.728/2021, të datës 02.11.2021, të paraqitura nga Munib Durguti, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për mungesë të votave në Vendvotimet 1626A/01R, 1601A/01R, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 02.11.2021, ka pranuar apelet Anr.726/2021, Anr.727/2021, Anr.728/2021, të dorëzuara nëpërmjet postës më datë 29.10.2021, nga Munib Durguti, kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Rahovec. Në apelin Anr.726/2021 kandidati në fjalë pretendon se në Qendrën e Votimit, Shkolla “Isa Boletini” vendvotimi 1626A/01R, pas përfundimit të zgjedhjeve pas orës 19:00 është publikuar FRP-ja, me numrin e lartcekur i cili ishte vështirë të lexohet, mirëpo pas fotografimit të të njëjtit dhe hapjes së FRP-së me ndihmën e programit është vërejtur se aty i ka 23 vota ndërsa në formularin e publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së figurojnë vetëm 2 vota.

Në apelin Anr.727/2021, pretendohet se në vendvotimin 1601A/01R, i figurojnë gjithsej 20 vota, dhe pretendon se në këtë vendvotim nuk i kanë dalur as gjysma e votave të cilat iu kanë konfirmuar nga familjarët.

Në apelin Anr.728/2021, parashtruesi i apelit pretendon se dy kandidatët për Kuvend Komunal nga LVV-ja, në Rahovec të cilët janë vëlla e motër kanë marrë vota me numër identik me të cilën

dyshojnë se si kanë mundur të votojnë qytetarët dy kandidat kur është e lejuar vetëm një, si dhe siç theksohet të dytë e kanë burimin e njëjtë të votave nga familjarët. Lidhur me këtë pretenduesi i apelit dyshon se është bërë parregullsi nga komisionerët që pretendojnë se janë familjarët e përfaqësuesit të LVV-së, në KKZ me të cilën pretendon se kanë bërë ndryshimin e votave të kandidatëve për Kuvend Komunal, Sinan dhe Shqipe Kryeziu në fshatin Xërxë, Komuna e Rahovecit, dhe nga kjo parregullsi kandidati në fjalë thekson se i mungojnë votat e tij.

Parashtruesi i apeleve kërkon nga paneli që të bëhet rinumërimi i këtyre VV si dhe rinumërimin e vendvotimeve në qytetin e Rahovecit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e apeleve, gjeti se:

Apelet janë të palejuara

Paneli bazuar në nenin 13 paragrafi 2 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim”*, Paneli bëri bashkimin e apeleve dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në apele përkitazi me parregullsitë në vendvotimet me të cilat pretendon ankuesi lidhur me qendrën e votimit, Shkolla “Isa Boletini” nr. 1626A/01R, dhe në vendvotimin 1601A/01R, në vendvotimin në fshatin Xërxë, si dhe shkeljet e tjera të pretenduara, për faktin se shkeljet që ndërliohen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar për kandidatët për Kuvend Komunal nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ti hudhë si të parakohshme apelet e ankuesit. Hudhja e apeleve nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes apele tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, për Kandidatët për Kuvend Komunal nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 726/2021 më datën 03.11.2021

Kryesuesi i Panelit



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.